



THIRRJE PËR POZICION TË LIRË PUNE

Pozicioni: Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Administratës

1. Cfarë po kërkojmë ne?

Autoriteti i Aviacionit Civil ka për qëllim rekrutimin e profesionistëve të fushës dhe përthithjen e ekspertëve në kuadër të rritjes së kapaciteteve.

Në këtë thirrje Autoriteti i Aviacionit Civil kërkon të rekrutojë profesionistë të fushës, me eksperiencë në administratën publike ose dhe korporata private.

2. Detyrat e pozicionit të punës

- a) Siguron mirëfunksionimin e sistemeve dhe infrastrukturës elektromekanike, hidraulike, ndërtimore të godinës së institucionit, si dhe të pajisjeve të tjera që janë në përdorim në përputhje me parametrat e duhura;
- b) Ndjek dhe realizon mirëadministrimin e logjistikës, për realizimin në kohë e me cilësi të shërbimeve të punonjësve të AAC.
- c) Siguron mbarrëvajtjen e eventeve të organizuara nga AAC ku përfshihet suporti teknik, menaxhimi i hapësirave dhe mjeteve të mevojshme për kryerjen e tyre.

3. Kërkesat e pozicionit të punës

- a) Edukimi: Diplomë Master shkencor apo Master profesional në Shkenca Inxhinierike/Juridike/Ekonomike.
- b) Gjuhë e huaj : Anglisht Niveli B1 (ose ekuivalente)
- c) 7 vjet eksperiencë pune në çështje të lidhura me logjistikën nga këto 3 vite eksperiencë në pozicion drejtues.

4. Dokumentacioni për dorëzim

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti.
- b) Diplomë Bachelor dhe/ose master e noterizuar.
- c) Fotokopje e librezës së punës.
- d) Vërtetim i gjendjes shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- e) Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
- f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

5. Aftësi të tjera

- a) Aftësi shumë të mira komunikuese
- b) Aftësi organizative
- c) Aftësi për të punuar në grup
- d) Aftësi drejtuese

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për edukimin, përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

Vlerësimi maksimal për dokumentacionin është **40 pikë**

Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është **60 pikë**

Kandidatët që marrin të paktën 60 pikë në vlerësimin e përgjithshëm renditen te lista e pritjes

SHPLLJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, (vlerësimi i dokumentacionit dhe intervistës me gojë) Njësia e Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil do të shpallë fituesit në faqen e tij të internetit. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit. Afati i ankimit është **5 ditë** nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar.

Nëse mendoni se plotësoni kriteret e mësipërme Autoriteti i Aviacionit Civil ju fton të aplikoni në adresën zyrtare [rekrutime@acaa.gov.al/](mailto:rekrutime@acaa.gov.al)

Vetëm aplikantët të cilët kanë përmbushur kriteret e përcaktuara në shpallje do të njoftohen për intervistë.